



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr.442/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës: Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, dhe Kaltrina Avdullahi Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit me numër Anr.1651/2023 të datës 11.07.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.442/2021 të parashtruar nga ankuesja të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Avokatja me kundër Vendimit me numër KD:Nr.01/2021 të datës 05.03.2021, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 29.12.2023 mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.442/2021 e datës 24.05.2021 të parashtruar nga ankuesja
- II.MBETET në fuqi Vendimi me numër KD: Nr. 01/2021, i datës 05.03.2021, i Komisionit Disiplinor të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

A r s y e t i m

Ndaj ankueses _____ e punësuar sipas Akt Emërimit me numër të protokollit Nr. ZBNj/DP-120/2013 të datës 22.02.2013, në pozitën e punës „Referente” në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, më datë 03.02.2021 Administratorja e Prokurorisë Themelore në Prishtinë në cilësinë e mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë ka parashtruar kërkesë me numër Nr.139 për iniciimin e procedurës disiplinore në Komisionin Disiplinor, për shkak të shkeljeve të detyrave të punës.

Komisioni Disiplinor i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, më datë 05.03.2021 ka nxjerrë Vendim me numër KD.Nr.01/2021 përmes së cilit ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore „Pezullohet ushtrimi i detyrave dhe i ‘u ndalohe 1/3-ta e rrogës për një periudhë prej dy (2) muaj”.

Ankuesja e pakënaqur me Vendimin me numër KD.Nr.01/2021 të datës 05.03.2021 të Komisionit Disiplinor të Prokuroris Themelore, përmes përfaqësueses së autorizuar _____ më datë 31.03.2021 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Komisioni Disiplinor për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës ka nxjerrë Vendim me numër KA. Nr. 04/2021 përmes së cilit e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ushtruar nga përfaqësuesja e autorizuar Rexhepi duke e lënë në fuqi Vendimin me numër KD.Nr.01/2021 të datës 05.03.2021 të Komisionit Disiplinor të Prokuroris Themelore.

Ankuesja e pakënaqur me Vendimin me numër KA.Nr.04/2021 të datës 05.03.2021 të Komisionit të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, përmes përfaqësueses së autorizuar _____ ka parashtruar ankesë me numër protokoli 2589/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 09.06.2021, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës. Ndërsa Këshilli më datë 14.06.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga data 30.06.2021 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankueses, ndërsa me datën 08.07.2021 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës dhe e ka udhëzuar se mund të ndjek procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja ka ndjekur procedurat e tjera, duke iniciuar Konflikt Administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me datën 11.07.2023 ka nxjerrë Aktgjykimin me numër A.nr.1651/2021, sipas të cilit ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses dhe ka anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 08.07.2021, duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të vendos për ankesën e datës 24.05.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Aktgjykimin me numër A.nr.1651/2021 të datës 11.07.2023 të Gjykatës Themelore/ Departamenti për Çështje Administrative; Kërkesën për Zbatimin e Aktgjykimit të Plotfuqishëm me numër protokoli 442/2021 të datës 24.08.2023; Njoftimin me numër protokoli 3555/21 të datës 08.07.2021;



Kërkesën për informata zyrtare të datës 29.06.2021; Fletkthesë e datës 04.06.2021; Ankesën me numër protokolli 2589/2021 të datës 24.05.2021 të parashtruar nga përfaqësuesja e autorizuar Av.Shpresa Berisha-Rexhepi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizim i datës 30.03.2021; Vendimin me numër KD.Nr.01/2021 të datës 05.03.2021; Ankesën e datës 31.03.2021 të parashtruar nga përfaqësuesja e autorizuar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Vendimin me numër KA.Nr.04/2021 të datës 26.04.2021; Konkurs i datës 08.02.2021; Procesverbal i seancës së Komisionit Disiplinor i datës 22.02.2021; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 03.06.2021; Përgjigje në ankesë e datës 14.06.2021; Fletëdërgesë e datës 09.06.2021; Akt Emërim me numër protokolli Nr.ZBNj/DP-120/2013 i datës 22.02.2013; Përshkrimin e detyrave të punës; Kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore me numër Nr.139 të datës 03.02.2021; E-mail i datës 12.01.2021; Aktvendimin me numër PKR.nr.707/20 të datës 27.01.2021; E-mailat e datës 02.02.2021; Deklaratë e datës 08.07.2021; Libri për shkarkimin e prokurororëve me lëndë i datës 22.01.2021; Libri për shkarkimin e prokurororëve me lëndë i datës 25.01.2021; Libri për shkarkimin e prokurororëve me lëndë i datës 26.01.2021; Libri për shkarkimin e prokurororëve me lëndë i datës 27.01.2021; Libri për shkarkimin e prokurororëve me lëndë i datës 28.01.2021; Libri për shkarkimin e prokurororëve me lëndë i datës 29.01.2021; Të dhënat për raportin javor prej datës 25.01,2021 deri më 29.01.2021; Libri i ekspedicionit; Pliko e datës 14.03.2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesja dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankueses

është e pabazuar, sepse:

Ankuesja në ankesën e datës 24.05.2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Vendimi me numër KA.Nr.04/2021 i datës 26.04.2021 i Komisionit të Ankesave në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës si dhe Vendimi me numër KD.Nr.01/2021 të datës 05.03.2021 i Komisionit Disiplinor i Prokurorisë Themelore përmbajnë, shkelje të dispozitave të Rregullores Nr.04/2021 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil dhe shkelje të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Nëpunësit Civil.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Prokurorisë Themelore në Prishtinë me rastin e nxerjes së Vendimit me numër KD.Nr.01/2021 të datës 05.03.2021 ankuesen e ka shpallur përgjegjëse për shkelje të rëndë duke i shqiptuar masën disiplinore „*Pezullohet ushtrimi i detyrave dhe i 'u ndalohej 1/3-ta e rrogës për një periudhë prej dy (2) muaj'*”, me arsyetimin se e njëjta ka bërë shkelje të detyrave të punës për shkak të lëshimit të afatit 24h të Aktvendimit me numër PP.I.42/20 i cili është pranuar në Prokurorinë Themelore në Prishtinë më datë 28.01.2021, dhe i njëjti aktvendim nuk është proceduar me tutje tek prokurorja e rastit nga ana e ankueses, me ç'rast është humbur afati për ushtrimin e ankesës.

Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses si dhe duke u bazuar në provat e administruara të lëndës, ka konstatuar se më datë 12.01.2021 përmes e-mailit zyrtar të Udhëheqësit të Shkrimoreve ankueses i është caktuar referati i pranimit dhe procedimit të aktgjykimeve, ftesave dhe shkresave të tjera të pranuar nga Departamenti i Krimeve të Rënda, ndërsa në librin për shkarkimin e prokurorëve me lëndë, më datë 28.01.2021 ankuesja e ka pranuar Aktvendimin me numër PKR.nr.707/20 të datës 27.01.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë i cili në Prokurorinë Themelore është pranuar më datë 28.01.2021 dhe ka marrë numrin PP.I.42/20 dhe e njëjta nuk e ka proceduar tutje te prokurorja e rastit e me ç'rast është humbur

afati për ushtrimin e ankesës të një rasti shumë të ndishëm. Mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ankuesja ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 51 paragrafit 1, i Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet qartë se: „ *Nëpunësit civilë i ushtrjnë detyrat e tyre në bazë të kushteve të përcaktuara me ligj dhe në përshkrimin e detyrave të punës në mënyrë të saktë, të ndërgjegjshme, të rregullt, në kohë dhe pa interes vetjak, në përputhje me interesin publik dhe në përputhje me sistemin juridik të Republikës së Kosovës*”, si të veçantë, i ushtrjnë funksionet e vendit të tyre përkatës të punës”. Andaj marrë parasysh konstatimin e lartë cekur Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesja ka bërë shkelje të detyrave të punës duke lëshuar afatin prej 24h të Aktvendimit të pranuar nga ana e saj si dhe mos procedimit në kohë të Prokurorja e rastit, sepse edhe sipas formularit të përshkrimit të detyrave të punës ankuesja si një nga detyrat dhe përgjegjësit kryesore është edhe ndarjen e lëndëve të prokurorët sipas nivelit të Prokurorisë dhe përcjellja e lëvizjes së lëndëve në Prokurori, përcjell shkresat të Institucionet përkatëse, përcjellë pranim dorëzimin e lëndëve nga Sekretarët Juridik/ Zyrtarët Ligjor.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave theksuar si më sipër ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Prokurorisë Themelore në Prishtinë me rastin e nxerrjes së Vendimit me numër KD.Nr.01/2021 të datës 05.03.2021 përmes së cilit ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore „*Pezullimi i ushtrimit i detyrave dhe ndalimi i 1/3-ta së pagës për një periudhë prej dy (2) muaj*”, me arsyetimin se e njëjta është përgjegjëse për shkelje të rënda disiplinore konkretisht „*shkelje e detyrave të punës që kanë pasojë për palën dhe organin shtetëror*” të përcaktuar me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.10 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, ka vepruar drejtë dhe në mënyrë të plotë ka arritur të konstatojë gjendjen faktike dhe bazën juridike duke vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 67 paragrafi 1.2 pika 1.2.2 të Ligjit Nr.03/149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, gjithashtu edhe masa disiplinore „*Pezullim i ushtrimit i detyrave dhe ndalimi i 1/3-ta e pagës për një periudhë prej dy (2) muaj*” e shqiptuar ndaj saj ka qenë në harmoni të plotë me shkeljen e bërë nga ana e saj si dhe me Rregulloren Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, nga rrjedhë se edhe Komisioni për Zgjedhjen dhe Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatën e Këshillit Prokurorial të Kosovës ka vepruar sakt me rastin e nxerrjes së Vendimit me numër KA.Nr.04/2021 të datës 26.04.2021 duke e refuzuar ankesën e ankueses dhe duke e lënë në fuqi Vendimin e Komisionit Disiplinor. Mbi këtë bazë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se pretendimet ankimore të ankueses, janë të pabazuara

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër Vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar Vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.442/2021

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Avokates
- Gjyqtare Lirije Maksutaj, Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative;
- Njesisë së Burimeve Njërëzore në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.